



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1251 Prot.

Tiranë, më 15.09 2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 61 dt. 15.09 2026

**PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME
STAF AKADEMIK PËR TRE NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE
TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027**

Në zbatim të nenit 49, pika 1, gërma (ç), të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", në VKM me nr.123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës" në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë", të ndryshuar, në VKM me nr. 647, datë 5.10.2022 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë", të ndryshuar, në VKM me nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", në Udhëzimin e MASR me nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet publike të Arsimit të Lartë", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes me nr. 1631/1 prot., datë 09.09.2026 "Kërkesë për personel akademik të jashtëm për vitin akademik 2026-2027 në FSHL", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit me nr. 1631/2 prot., datë 10.09.2026 "Planifikimi për personel akademik me kohë të pjesshme pranë FVFR, për vitin akademik 2026-2027", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit me nr. 1631/3 prot., datë 10.09.2026 "Planifikimi për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2026-2027", pranë FSHR-së", në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik nr. 121 datë 14.09.2026, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 15.09.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik për tre njësitë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027, si më poshtë:

1.1 Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FSHL	13 persona
1.2 Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FVFR	10 persona
1.3 Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FSHR	18 persona

- 2 Efektet financiare mbulohen nga të ardhurat e Universitetit të Sporteve të Tiranës.
- 3 Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë Kryesore, Administratori, Drejtoria e Burimeve Njerëzore Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
- 4 Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

